

REPUBLIC OF KOSOVO		MINISTRY OF JUSTICE	
AGENCY		AGENCY	
Dep.	DPK/DMP	Ref.	03-3894/12
Dep.		Ref.	
Dep.		Ref.	
Dep.	02	Ref.	30.10.2012
Dep.		Ref.	

Nr. Regj. 32184/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, gjyqtaria Azra Cakolli me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Feti(Lazam)Mehdiu, nga Matiqani Komuna e Prishtinës, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 dhe nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet(LK) GZ KSAK 23/79, më datë 22.10.2012 morri këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Feti(Lazam)Mehdiu, i lindur më 20.01.1944 në fshatin Zajazë, Komuna e Kërçovës, tani me vendbanim në rrugën "Isa Kastratit", pn, në Matiqan, Këshilltar Komunal në Prishtinë, i martuar baba i katër fëmijëve, ka kryer fakultetin Filozofikë, i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse si zyrtarë i lartë publik në pozitën e Këshilltarit Komunal në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetorë të pasurisë, brenda afatit të paraparë ligjor gjer më 31 mars 2012, -
- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, andaj i shqiptohet,

D Ë N I M I

Më gjobë në shumë prej 450(katërqindpesëdhjetë)€, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjëren agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke iu llogaritur nga 15 €, për një ditë burgu.
Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është e obliguar të paguaj shumën prej 5.€, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje e këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë, i parashtroi kësaj gjykate kërkesën Nr. 01-2502/2012 me datë 07.08.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurit, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, e të cilën kërkesë i vihet në barrë se në Agjencinë Kundër Korrupsion nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e rregullt vjetor të pasurisë deri më datën 31 mars të vitit 2012.

03-3894/12/02
feng

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se e ka bërë deklarin e rregullt vjetorë por me vonesë duke ia prezantuar Vërtetimin nr. 03/3643/12 të datës 22.08.2012. Nuk ka pas njohuri se pasi që një herë e ka deklaruar pasurinë duhet ta bënë dhe deklarin e rregullt vjetorë duke pranuar kundërvajtjen dhe shpreh keqardhje për këtë çka ka ndodhur.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimit të deklaratës së të pandehurit, si dhe vlerësimi i shkresave të tjera të lëndës e posaçërisht nga administrimi i provës materiale të prezantuar si që është Vërtetimin nr. 03/3643/12 të datës 22.08.2012. se ka bërë deklarin me vonesë çka do të thotë se nuk i ka ikur obligimit ligjorë por nuk ka pas njohuri të mjaftueshme lidhur me ligjin në fjalë e poashtu duke pas parasysh moshën e tij, gjyqtaria në mënyrë bindëse vërtetoi se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, për çka e shpalli përgjegjës dhe e dënoj me gjobë duke aplikuar nenin 9 nën minimumin e paraparë me ligj ashtu si është cekur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, nën të cilat është kryer kundërvajtja, peshën e veprës së kryer, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë, andaj i shqiptoj dënimin me gjobë nën minimumin e paraparë, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Me sa u tha u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. Regj. 32184/2012, datë 22.10.2012

Gjyqtaria
Azra Çakoli

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.